



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1002/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen përmbarimore të kreditorit, SH.I nga fshati ..., Komuna e Obiliqit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit F.SH., avokat nga Prishtina kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës në Prishtinë –Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të borxhit, vlera 11,928.00 euro duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.767/20, i datës 17.09.2020, me datë 28.04.2022 mori këtë:

### A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.767/20, i datës 17.09.2020, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm dhe rivendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e atakuar, PP.nr.767/20, i datës 17.09.2020 e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës në Prishtinë –Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit i ushtruar kundër urdhrin të përmbaruesit privat F.H nga Prishtina, P.nr.799/19, i datës 09.10.2019 mbi caktimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, ndërsa aktvendimi PPP.nr.767/20, i datës 17.09.2020 të shfuqizohet dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 06.07.2020 ka paraqitur propozim pranë organit përmbarues për përmbarimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, CN.nr.429/13, i datës 28.07.2017 i ekzekutueshëm me datë 19.06.2020.

Përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin me urdhrin, P.nr.103/2020, i datës 06.07.2020.

Debitori pas pranimit të urdhrit ka parashtruar, prapësim pranë Gjykatës së shkallës së parë duke kërkuar aprovimin e prapësimit dhe shfuqizimin e urdhrit përmbarimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PP.nr.767/20, i datës 17.09.2020 e ka refuzuar në tërësi si i pa bazuar prapësimin, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Ne aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se prapësimi është i pa bazuar sepse debitori nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së e në të cilat bazohet prapësimi i palës. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka vlerësuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.429/13, i datës 28.07.2017 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4191/17, i datës 03.03.2020 në bazë të së cilit përmbaruesi privat e ka zbatuar përmbarimin, i cili dokument përmbarues përbën bazë juridike për zbatimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 i LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së.

Gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, Gjykata e Apelit vëren se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i pa qëndrueshëm për faktin se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin.

Nga shkresat e lëndës vërehet se Përmbaruesi privat ka bërë lejimin e përmbarimit me urdhrin, P.nr.103/2020, i datës 06.07.2020, ndërsa në dispozitiv të aktvendimit të atakuar Gjykata e refuzon prapësimin e debitorit kundër një urdhri tjetër përmbarimor, P.nr.799/19, i datës 09.10.2019, ndërsa në arsyetim të aktvendimit Gjykata e përmend se prapësimi është ushtruar kundër urdhrit, P.nr.103/2020, i datës 06.07.2020.

Gjykata ankimore vlerëson se duke pasur parasysh këtë fakt aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë si i tillë nuk mund të qëndrojë për arsye se është i pa qartë dhe si i tillë shkakton konfuzitet për faktin se nuk mund të dihet se cili urdhër i Organit Përmbarues është lënë në fuqi, apo ndaj cilit urdhër është paraqitur prapësim nga ana e debitorit e që e bën edhe të pa përmbarueshëm vendimin e tillë.

Meqenëse kjo Gjykatë gjeti se ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk u lëshua në bazat tjera ankimore.

Në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të kësaj Gjykate ashtu që të eliminojë çdo paqartësi në lidhje me urdhrin përmbarimor ndaj të cilit është ushtruar

prapësimi, e më pas të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore, e në veçanti ti përmbahet nenit 160 të LPK-së që kanë të bëjnë me përpilimin e vendimit.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1002/21, me datë 28.04.2022

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v